



Manuali i montimit

Quality, Design and Innovation



home.liebherr.com/fridge-manuals



LIEBHERR

Informacionet e montimit

Përmbajtja

1	Informacionet e montimit.....	2
1.1	Lidhja e pajisjes në një agregat të jashtëm ose në një ftohje qendrore.....	2
1.2	Komponentët.....	2
1.3	Kërkesa minimale / kërkesa energjetike kur lidhet një pajisje e vetme.....	2
1.4	Procesi i montimit.....	2
1.5	Lidhja elektrike.....	3
1.6	Testimet dhe kontrollet.....	3

1 Informacionet e montimit

1.1 Lidhja e pajisjes në një agregat të jashtëm ose në një ftohje qendrore

Shënim

Në një agregat të jashtëm mund të lidhni vetëm pajisje të parapërgatitura në mënyrë të posaçme në versionin "r" si p.sh. FRTSrg, FFTRg.



VINI RE

Rrezik për shëndetin për shkak të gazit ftohës / azotit që rrjedh jashtë!

Vështirësi në frymëmarrje.

► Sigurohuni që pajisja të lidhet në një agregat të jashtëm ose në një ftohje qendrore vetëm nga një specialist i trajnuar i teknologjisë së ftohjes.



VINI RE

Rrezik për shëndetin nga pjesët që përçojnë energji elektrike!

Goditje elektrike.

► Përpara fillimit të punimeve të montimit: Hiqni spinën elektrike nga priza.

1.2 Komponentët

Valvulat e mëposhtme termostatike të zgjerimit janë të integruara:

- **Ftohësi:** Danfoss Thermostatic Expansion Valve TN2 068Z3384.
- **Ngrirësi:** Danfoss Thermostatic Expansion Valve TN2 068Z3384.

1.3 Kërkesa minimale / kërkesa energjetike kur lidhet një pajisje e vetme

Modeli	Tensioni	Rryma e thithur	Fuqia
Ftohës	220-240 V ~ 50/60 Hz	4,02 A	840 W
Ngrirës	220-240 V ~ 50/60 Hz	4,4 A	970 W

Modeli	Kapaciteti i freskimit	Të dhënat
Ftohës Gjerësia: 1160 mm	519 W	Gazi ftohës R452a, -10 °C temperatura e avullimit, Temperatura e lëngëzimit +55 °C

Modeli	Kapaciteti i freskimit	Të dhënat
Ftohës Gjerësia: 1640 mm	668 W	Gazi ftohës R452a, -10 °C temperatura e avullimit, Temperatura e lëngëzimit +55 °C
Ftohës Gjerësia: 2120 mm	668 W	Gazi ftohës R452a, -10 °C temperatura e avullimit, Temperatura e lëngëzimit +55 °C
Ngrirës Gjerësia: 1160 mm	540 W	Gazi ftohës R452a, -30 °C temperatura e avullimit, Temperatura e lëngëzimit +55 °C
Ngrirës Gjerësia: 1640 mm	540 W	Gazi ftohës R452a, -30 °C temperatura e avullimit, Temperatura e lëngëzimit +55 °C
Ngrirës Gjerësia: 2120 mm	656 W	Gazi ftohës R452a, -30 °C temperatura e avullimit, Temperatura e lëngëzimit +55 °C

1.4 Procesi i montimit



VINI RE

Rrezik për shëndetin për shkak të gazit ftohës / azotit që rrjedh jashtë!

Vështirësi në frymëmarrje.

► Hapni me kujdes linjën e gazit ftohës.



VINI RE

Dëmtime në pajisje për shkak të ujit të kondensimit!
Korrozion i komponentëve.

► Mos shkurtoni tubat e gazit ftohës në pjesën e izolimit.
► Futni tubat e zgjatur të gazit ftohës brenda një tubi izolues.

Shënim

Zvogëlim i kapacitetit të ftohjes.

► Nëse zgjatni tubat e gazit ftohës: mos e zvogëloni diametrin e brendshëm të tubave.

► Shtroni tubacionet e gazit ftohës që furnizohen në pjesën e pasme të pajisjes në varësi nga rrethanat e konstruksionit në agregatin ftohës ose në varësi nga rrethanat e tubacioneve të gazit ftohës në anën e ndërtesës.

- \varnothing e linjës së thithjes 10 x 0,7 mm
- \varnothing e linjës së presionit 6 x 0,7 mm

Pajisjet janë të kompletuara me një valvul gazi ftohës (valvul mbyllëse), që është e lidhur më parë me sistemin elektronik. Temperatura rregullohet përmes hapjes dhe mbylljes së valvulës. Valvula termostatike e zgjerimit ndodhet në hapësirën e motorit.

- ▶ Nëse nevojitet, rregulloni mbinxehjen në valvul. Rregullimi nga fabrika është 4K. 1 rrotullim në drejtim të akrepave të orës korrespondon me një mbinxehje 2K më të lartë.
- ▶ Në mënyrë që sistemi të zbrazet, duhet të montoni lidhjen përkatëse. Zbrazja është e mundur vetëm në anën e presionit, sepse valvula lejon qarkullimin në këtë drejtim. Nuk lejohet që zbrazja të bëhet vetëm në anën e thithjes, sepse në këtë rast tubacioni nga valvula e mbylles deri në pikën e lidhjes në anën e konstruksionit nuk do të zbrazej.
- ▶ Nëse keni liruar bobinën e elektrovalvulës, atëherë mund ta hapni valvulën me ndihmën e një magneti rrethor të përshtatshëm. Hapja e saj kuptohet në mënyrë akustike nga një klikim.
- ▶ Për të shmangur zhurmat e lëkundjes dhe këputjet e tubacioneve të gazit, ato duhen shtruar në mënyrën e duhur.

Sistemi është testuar në fabrikë për rrjedhje. Për shkak të përthyerjes së tubacioneve dhe, sipas rastit, të zhvendosjes së mbinxehjes, mund të ndodhin rrjedhje.

- ▶ Kontrolloni për rrjedhje vendet e ngjitjes.
- ▶ Në pjesën e kalimit të tubave duhet bërë kujdes që të mos ketë asnjë hapësirë të paizoluara.

1.5 Lidhja elektrike

- ▶ Lidhni pajisjen në rrjetin elektrik.

Shënim

Ju nuk mund ta komandoni agregatin e jashtëm të gazit ftohës përmes ndërfaqes së përdorimit të pajisjes, për shkak se pajisja nuk ka asnjë ndërfaqe për këtë qëllim.

1.6 Testimet dhe kontrollet

- ▶ **Kontrollet për rrjedhje:** Kontrolloni për rrjedhje të gjitha vendet e ngjitjes dhe lidhjet me filetë.
- ▶ **Prova e funksionimit:** Kontroll i të gjitha gjendjeve të punës (ftohje, shkrirje), duke pasur parasysh përshkrimet e elementeve të përdorimit dhe të elementeve të komandimit, sipas manualit të instruksioneve të përdorimit.
- ▷ Gabimet në funksionim sinjalizohen përmes alarmeve të ndryshme. Avaria e impiantit të ftohjes qendrore sinjalizohet nëpërmjet një alarmi të temperaturës.



home.liebherr.com/fridge-manuals

sq Frigoriferi ftohës dhe ngrirës

Data e botimit: 20231109

**Indeksi i nr. të
artikullit: 7083620-00**

Liebherr Hausgeräte Lienz GmbH
Dr.-Hans-Liebherr-Strasse 1
A-9900 Lienz
Österreich